



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 451/2 prot.,

Datë 26.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “3 - Sh” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: “*Loti IV– “Blerje artikuj ushqimor kolonial”* me fond limit 54,521,956 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane.
- Ankimues:** “3 - Sh” SHPK, me NUIS K62721401R, me adresë: “1 Maji”, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane me adresë: Rr. “Barrikadave”, Tiranë

Në datën 23.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3829, protokolluar në datën 26.02.2024 me nr. 451/2024 protokollin e operatorit ekonomik “3 - Sh” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: “*Loti IV– “Blerje artikuj ushqimor kolonial”* me fond limit 54,521,956 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “3 - Sh” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “3 - Sh” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 451 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*Kriteret e veçanta, pika 2.3.1. Referuar nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit provues të depozituar në SPE nga OE “3SH”, konkretisht në lidhje me faturat tatimore, kërkoi verifikimin e tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Me 23.02.2024, nga DPT jemi informuar se 96 fatura rezultojnë në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi dhe 94 fatura rezultojnë të dubluara. Persa më sipër, vlera e faturave të cilat janë në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nuk plotëson vlerën e 40% të fondit limit. Si pasojë ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur. 1.2 Kriteret e veçanta, pika 2.3.8 dhe 2.3.9, operatori ekonomik nuk ka paraqitur në SPE dëshmi të testimeve zyrtare për artikujt e këtij Loti.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 26.02.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**